

TEATËR PËR KRISHTLINDJE

Treguesi 1: Në fillim ishte Fjala, e Fjala ishte Hyji. Ai e Krijoi gjithësinë

dhe bota nuk e njohu atë. Ata nuk e pranuan të vërtetën, mirësinë, dritën paqen, por deshën të rrinë në errësirë, pranuan terrin më parë se dritën, pranuan luftërat më parë se paqen, pranuan gënjeshttrat më parë se të vërtetën, pranuan shkatërrimin më parë se bashkimin, pranuan egoizmin duke ndërtuar jetën e tyre në materializëm sesa jetën në bashkëpunim me Hyjin e me njerëzit.

Fëmija 1: Oh do shkoj në diskotekë sonte, a do vish me mua?

Fëmija 2: Jo se nesër kam provim e nuk jam përgatitur!

Fëmija 1: Eh po ç'të duhet shkolla, me lodh trutë kot..., Më mirë hajde me mua të shkojmë e të bëjmë qejf....në diskotekë....!!!

Fëmija 2: *Mendohet....*Jo, jo nuk mundem se nuk më lënë prindërit?

Fëmija 1: Po, kush i pyet prindërit, more....a je budalla? Akoma ti merr mendimin e mamasë.....eh çun mamaje....? Hajde, hajde....!!!!

Ikin të dy, futet një muzikë diskoteke.....

Hyjnë një grup. 4-5 të dehur....tu pi duhan....ah qejfi ynë, eh duam të pimë duhan, duam të pimë drogë.....duam të kërcëjmë...duam të hamë e të pimë duam një mercedes....duam të shëtisim nëpër botë....nuk mund të jetojmë pa to....

Dhuna: Gëzimi im është dhuna: Eh, dialog, dialog, këtu ajo që fiton është ai më i forti. Për këtë unë stërvitem përditë, që të sundoj botën.

Egoizmi: Gëzimi im është egoizmi: Më intereson vetëm vetvetja, të tjerët nuk më interesojnë më. Me jetën time bëj atë që ndjej, të tjerët më bezdisin. E rëndësishmja jam unë. Të tjerët nuk ekzistojnë.....Kërkon që të tjerët të ikin sepse me shqetësojnë.....mbete vetëm.

Konsumizmi: Gëzimi im është konsumizmi: Mund të shkojë nga një person në tjetrin duke i vlerësuar gjithçka kanë....rroba, kompjuter, celular....Jam me fat se kam prindërit shumë të pasur e më blejnë gjithçka ju kërkoj. E rëndësishme në jetë të jem i pasur, të kem shumë pasuri, të kaloj jetën duke harxhuar....Sa më shumë të blejë aq më i lumtur jam....

Gënjeshtra: Gëzimi im është të gënjej: Flet me ndonjë e i thotë një gënjeshtrë....pastaj ai ik dhe thotë oh çë gënjeva....hyn tjetri.....thotë një gënjeshtrë tjetër.....gjithçka është gënjeshtrë....edhe unë jam gënjeshtrë....por mua nuk arrijnë të më gënjejnë....

Treguesi 2: Gjithçka është shkatërruar....gjithçka është e zezë....gjithçka shihet se po merr fund.....por muzikë këngë se non ti ami, e errësirë.....Dëgjohen tre zëra të njëjta të tre personave, oh shkatërrim, gënjeshtra, egoizëm, materializëm, vetmi....

Zoti: Njeriu po largohet prej meje, kam dërguar profetët dhe nuk i kanë dëgjuar. Tani duhet të marrim një vendim tjetër, për ta shpëtuar njerëzimin. Duhet të dërgoj birin tim, të bëhet i vogël, të jetojë si jetojnë njerëzit e thjeshtë, të dashur, tolerant, të drejtë, punëtor, sepse vetëm kështu, njeriu do ta kuptojnë se sa shumë e dua.

Treguesi 3: Zoti donte të sillte birin e tij në tokë, për shpëtimin e njerëzve dhe thërret engjëjt.

Hyjnë 4 engjëj.

Engjëlli 1 (i shpejti): Mund të jem unë i zgjedhuri, të sjell lajmin e mirë. Unë jam më i shkathëti, më i shpejti ua kaloj të gjithëve, nëse ndokush më del përpara i jap një shqelm dhe e rrëzoj përtokë, nuk dua që të ma kalojë askush!

Engjëlli 2 (i zgjuari): Do shkoj unë, se flas shpejt e pa gabime, fjalët e mia janë brisk, patjetër që mua do më dërgojë Zoti.

Engjëlli 3 (fantaziozi): Jam unë që do të shkoj, që të thuhet një lajm i tillë duhet shumë fantazi. Sa shumë fantazoj edhe në shtëpinë time, saqë prindërit mendojnë se janë të vërteta, hahahahah!

Engjëlli 4 (i forti): Lëreni fjalët, unë jam i forti, më i forti i botës, ja çfarë muskuli kam. Që të shkoj në tokë duhet shumë forcë, vetëm unë mund ta bëj, patjetër se unë do të shkoj.

Zëri i Zotit: Pse mburreni, pse krenoheni, se asnjëri prej jush nuk do të shkojë, se unë kam zgjedhur engjëllin Gabriel që është i butë, i thjeshtë, i dashur.....

Del Engjëlli Gabriel.....duke kërcyer....e shkon tek Maria

Engjëlli Gabriel: Të falem, o Hirplote! Zoti është me ty!

Maria shqetësohet dhe Engjëlli i thotë përsëri

Engjëlli Gabriel:

Mos ki frikë, o Mari, sepse ke gjetur hir para Hyjit! Ja, do të mbetesh shtatzënë e do të nxjerrësh në dritë një djalë e ngjitja emrin Jezus. Ky do të jetë i madh dhe do të quhet Biri i Hyjit tejet të lartë. Zoti Hyj do t'ia japë fronin e Davidit, atit të tij. Ai do të mbretërojë përgjithmonë mbi shtëpinë e Jakobit dhe mbretëria e tij s'do të ketë mbarim.”

Maria:

Si do të mund të ndodh kjo, ndërsa unë jam virgjër?”

Engjëlli Gabriel:

Shpirti Shenjt do të zbresë në ty e fuqia e Hyjit të tejet lartë do të të mbulojë me hirin e vet; prandaj ky Fëmijë do të jetë i shenjtë - Biri i Hyjit. Dhe ja, Elizabeta, kushërira jote, edhe ajo, në pleqërinë e saj, pret t'i lindë djali. Vërtet, *s'ka gjë të pamundshme për Hyjin!*

Maria:

Unë jam shërbëtorja e Zotit: më ndodht siç the ti!

Maria: Eh si t'i them Jozefit për gjithçka më ka ndodhur, a do të besojë?..... *Futet Jozefi dhe sheh.....se çka ka ndodhur.....*

Kënga e Jozefit....

Pastaj shkon me Marinë rrugës.....

Maria: Jozef, sa e shndritshme po më duket kjo natë, plot me yje!

Jozefi: E vërtetë, është një natë më e ndriçuar se netët e tjera, por po bën shumë ftohtë.

Maria ndihet keq....

Jozefi: Prit Maria, po shkoj të kërkoj një strehim....*Troket....*a ka mundësi të na pranoni sonte në shtëpinë tuaj se kemi mbetur në mes të rrugëve.

Zoti i shtëpisë: Ikni se nuk ju njohim, e tani është shumë vonë....nuk kam vend për ju.

Jozefi: Ju lutem, sepse përjashta po bën shumë ftohtë.....

Futen në një stallë e lind fëmija.....

Ylli, shfaqet....një nxënës reciton:

Nxënësi: Një yll në qiell shfaqet duke lëshuar shumë dritë, në tokë ngadalë-ngadalë, zgjohet e bardha ditë. Edhe engjëjt në qiell sa janë, këndojnë me sa fuqi që kanë. E gjithë bota thotë është krishtlindje, është festa e paqes dhe e mirësisë, është festa më e bukur e njerëzisë.

Treguesi 3: Yje bëhuni gati se kush do të jetë ai që do të ndriçojë më shumë nga të gjithë për t'i treguar botës lindjen e Jezusit. Kush do të jetë ai që do t'i drejtojë mbretërit. Oh po flenë gjumë më duhet.

Ylli dembel: Oh, ishalla nuk po më thotë mua se po përtoj të shkoj!

Ylli mendjemadh: Pse të shkoj unë, nuk e di a më duan njerëzit.

Ylli Frikacak: Gjithmonë mua më thonë, unë kam frikë të shkoj, më mirë të rri këtu ku jam.

Ylli guximtar: Do të shkoj unë o shokë, pse e keni kaq problem. Unë e dua njerëzimin, e dua edhe këtë fëmijë që ka lindur, natën dua t'ua ndriçoj, ta marrin vesh të gjithë se në Betlehem ka lindur një yll që do ta ndriçojë mbarë botën.

Tre dijetarët: hyjnë në skenë kërkojnë Yllin.

Dijetari 1: Sa yll i shndritshëm, më duket si në pozicion që na fton për tu nisur në udhëtim.

Ylli guximtar: Hej, ejani pas meje dua t'ju njoh me një gjë të mrekullueshme!

Ata dalin nga skena..... Hyn Herodi:

Herodi: Gjatë kësaj nate nuk kam mundur të flejë, sa natë e keqe! Kushedi përse më vinin në mendje disa tundime të kryengritjes. Duhet të vëzhgoj, sepse nuk mund të rri i qetë nëse ndodh ndonjë gjë për pushtetin tim.

Hyjnë tre dijetarët:

Dijetari 2: Ku është foshnja e lindur, që do të bëhet mbreti i judenjve, sepse e pamë yllin e tij duke lindur dhe erdhëm t'i shprehim nderimet tona.

Herodi: Ha...ha...ha. Vetëm unë jam mbreti i tokës. Prandaj kam për të nxjerrë një ligj të ri. Sepse më duket se është një rrezik kryengritjeje. Nëse ndonjë do të dojë të bëhet Mbret duhet patjetër të flasë me mua!

Dijetari 3: Të gjithë profetët kanë thënë: do të jetë një profet i fortë, që kur të vijë të na bëjë ta dëgjojmë dhe do të sistemojë gjithçka, do të jetojmë të gjithë në paqe e nuk do të ketë më skllavëri.

Herodi: Nisuni e shikoni mirë se çfarë po ndodh në Betlehem, dhe ejani më lajmëroni për gjithçka!

Tre dijetarët: EH po mendon Herodi se do të bëjmë atë që thotë ai....boll na ka sunduar, tani kemi nevojë të jetojmë të bashkuar.....

Treguesi 4: Tre dijetarët shkojnë në Betlehem dhe i dhurojnë Jezusit fëmijë: **ar, kem e mirrë**, tre simbole të mbretërisë që **do, sakrifikon, dhe jep jetën e vet** për shpëtimin e njerëzimit.

Tre dijetarët lënë dhuratat dhe ikin nga skena

Hyjnë barinjtë.....

Engjëlli 1: Po ju sjelli një lajm të mirë, sonte në mesnatë ka lindur Krishti Zot. Do ta gjeni në një shpellë me Marinë nënën e tij dhe Jozefin, në një grazhd të mbështjellë me fashë.

Bariu1: Të lind një fëmijë në fshatin tonë?

Bariu 2: Si është e mundur që të gjithë njerëzit na përbuzin. Sepse jemi të varfër, rrimë gjithmonë me bagëti, e Zoti, pikërisht Zoti të vijë e të lind këtu.?

Engjëlli 2: Asgjë nuk është e pamundur për Hyjin, ai zgjodhi të lind i varfër, i thjeshtë, sepse vetëm kështu mund t'i dojë të gjithë. Ai vjen për të sjellë lavdinë e Zotit dhe paqe njerëzve mbi tokë.

Bariu 1: Unë po i sjell Krishtit këtë qengj të butë që ta ngrohë dhe të luaj me të.

Bariu2: Unë po i sjell ushqime, është i vogël dhe ka nevojë të hajë shumë që të rritet.

Bariu3: Unë po i fali këtë xhup, që të mbulohet me të, bën shumë ftohtë...

Bariu4: Unë po i dhuroj fyellin tim, kur të rritet të mësojë t'i bjerë, e t'u këndojë fushave dhe maleve.

Duke shprehur dëshirat i lënë dhuratat....pastaj barinjtë grumbullohen dhe thonë së bashku:

Kur jemi shokë, kur jemi miq, Krishti i vogël edhe në zemrat tona lind.

Eja o Krisht këtë vit lind tek ne, shtëpinë tonë mbushe me hare, sot për ty një valle do kërcëjmë, se vallja shqiptare ty shumë do të pëlqejë.

Vallja shqiptare.

Motrat Saleziare